

KUVENDI I KOMUNËS SË TUZIT
SHERBIMI I KUVENDIT



**UDHËZUES PËR QASJE TË INFORMACIONEVE NË KUADËR TË SHËRBIMIT TË
KUVENDIT TË KOMUNËS SË TUZIT**

Tuz, janar 2023

Në bazë të nenit 11 paragrafi 1 i Ligjit mbi qasjen e lire ndaj informacioneve ("Fleta Zyrtare e MZ", nr 44/12 dhe 30/19) sekretar i Kuvendit të Komunës së Tuzit, sjellë:

UDHËZUES PËR QASJE TË INFORMACIONEVE NË KUADËR TË SHËRBIMIT TË KUVENDIT TË KOMUNËS SË TUZIT

I – TË DHËNAT THEMELORE MBI SHËRBIMIN E KUVENDIT

Selia dhe adresa e Shërbimit të kryetarit të Komunës së Tuzit është në Tuz, rruga 1, nr.44 , tel/875-167, e-mail: skupstina.kuvendi@tuzi.org.me web faqja: www.tuzi.org.me

II – LLOJET E INFORMATAVE NË KUADËR TË SHËRBIMIT TË KUVENDIT

Aktet ormativë–

1. Ligjet:

- Ligji mbi vetëqeverisjen lokale ("Fleta Zyrtare e MZ", nr. 02/18,34/19,38/20,50/22,84/22),
- Ligji mbi financimin e vetëqeverisjes ("Fleta Zyrtare e MZ",n.r. 003/19),
- Ligji mbi zgjedhjen e këshilltarëve dhe deputetëve ("Fleta Zyrtare e MZ",n.r. 4/98, 5/98, 17/98,14/00, 18/00, 9/01, 41/02, 46/02, 48/06, 56/06 dhe ("Fleta Zyrtare e MZ", " n.r. 46/11,14/14 47/14, 12/16 dhe 10/18),
- Ligji mbi financimin e subjekteve politike dhe fushatave zgjedhore ("Fleta Zyrtare e MZ", n.r. 003/20).

2. Rregulloret që rregullojnë organizimin e Komunës dhe mënyra e punës së Kuvendit ,mënyra e ushtrimit të të drejtave dhe detyrave të këshilltarit:

- Statuti i Komunës së Tuzit ("Fleta Zyrtare e Malit të Zi – ", n.r. 24/19,05/20,51/22,55/22),
- Rregullore mbi punën e Kuvendit të Komunës së Tuzit ("Fleta Zyrtare e Malit të Zi - dispozitat komunale", n.r. 29/19),
- Vendim mbi themelimin e trupave punuese të Kuvendit të Komunës së Tuzit ("Fleta Zyrtare e Malit të Zi - dispozitat komunale", n.r. 015/19),
- Vendimi mbi kompensimin e këshilltarëve në Kuvendin e Komunës së Tuzit ("Fleta Zyrtare e Malit të Zi --dispozitat komunale" nr. 032/19)
- Vendim mbi themelimin e Shërbimit të Kuvendit ("Fleta Zyrtare e Malit të Zi - dispozitat komunale ", n.r. 029/19),

3. Akte të Kuvendit të Komunës:

- Buxheti dhe llogaria përfundimtare e Buxhetit
- vendimet për hartimin dhe miratimin e dokumenteve lokale të planifikimit,

planet dhe programet afatmesme dhe vjetore në fushat individuale administrative (programi i zhvillimit të truallit ndërtimor, programi i planifikimit dhe rregullimit hapësinor, etj),

- vendime për krijimin e shërbimeve publike (institucione publike, ndërmarrje, etj.),
- Vendime përmes të cilave sipas ligjit, rregullohen marrëdhëniet në veprimtari të posaçme nga kompetenca e vetëqeverisjes lokale,
- Programi i punës së Kuvendit Komunal të Tuzit,
- akte të tjera të cilat i sjellë Kuvendi Komunal i Tuzit në kuadër të kompetencave të veta (vendime, rekomandime, deklarata, përfundime, zgjidhje),
- Statutet e shërbimeve publike themelues i të cilave është Komuna (institucionet publike, institucionet ekonomike, ndërmarrjet) të cilave Kuvendi Komunal jep pëlqimin,
- programet e punës së shërbimeve publike të themeluara nga Komuna (institucionet publike, ndërmarrje, etj.) për të cilat Kuvendi Komunal jep miratimin e tij.

4. Materiale informative dhe të tjera të cila Kuvendi i shqyrton në zbatimin e politikës së caktuar dhe zbatimin e ligjeve, rregulloreve të tjera dhe akteve :

- raport mbi punën e kryetarit të Komunës dhe punën e organeve dhe shërbimeve të qeverisjes lokale,
- raporte për punën e shërbimeve publike të themeluara nga Komuna (institucionet publike, shoqëri afariste, etj),
- raporte, informacione dhe analiza për situatën në fusha të caktuara sociale të jetës, të përgatitur nga organet e qeverisjes vendore.

5. Materialet e informacionit dhe të dokumentacionit në lidhje me punën e Kuvendit të Komunës

- raportet e Komisionit Komunal të Zgjedhjeve për rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve të këshilltarëve në Kuvendin Komunal të Tuzit,
- Procesverbalet e seancave të Kuvendit Komunal,
- vendimet për themelimin e organeve të përhershme dhe të përkohshme të punës së Kuvendit Komunal,
- raporte nga seancat e trupave të përhershme dhe të përkohshme të Kuvendit,
- materiale të tjera të cilat i shqyrton Kuvendi Komunal.

6. Evidenca të cilat Shërbimi i Kuvendit i përfshinë në punën e vet:

- këshilltarëve në Kuvendin e Komunës së Tuzit,
- mbushja e vendeve të lira të këshilltarëve në Kuvendin e Komunës së Tuzit,
- Klubeve të kontituara të këshilltarëve në Kuvendin e Komunës së Tuzit,
- seancave të mbajtura, rrethete të ditës të seancave dhe prezencës së këshilltarëve në seancat e Kuvendit të Komunës së Tuzit dhe në trupat punuese të Kuvendit,
- pyetjet parlamentare dhe përgjigjet e pyetjeve të këshilltarëve,
- zyrtarëve publik të cilët i zgjedh, emëron dhe i shkarkon, ose në zgjedhjen, emërtimin ose shkarkimin e të cilëve Kuvendi i Komunës jep pëlqimin.
- shërbimeve publike themelues i të cilave është Komuna
- anëtarët e bordeve drejtuese dhe organet e tjera të menaxhimit të shërbimit publik themelues i të cilave është Komuna, e të cilat i emëron Kuvendi i Komunës,
- fituesve të çmimit "15 Dhjetori"

7. Aktet normative të Shërbimit të Kuvendit:

Rregullore mbi organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Shërbimin e Kuvendit

III – PROCEDURA E REALIZIMIT TË QASJES NË INFORMACIONE

1. Nisja e procesit:

Procedura fillohet përmes kërkesës në formë të shkruar ose gojore.

Për kërkesë nuk paguhet taksa administrative.

Kërkesa duhet të përmbajë:

- emrin e informacionit ose të dhënat në bazë të të cilave të bëhet i identifikueshëm,
- mënyra në të cilën kërkohet realizimi i qasjes në informacion,
- informacione mbi aplikantin (emrin, mbiemrin dhe adresën e personit fizik, ose emrin dhe adresën e personit juridik), gjegjësisht përfaqësuesit të tij, ose të autorizuarit,
- dhe informacione të tjera të rëndësishme për qasje në informacionin e kërkuar.

2. Mënyra e dorëzimit të kërkesës

- drejtpërdrejt në arkivin e Komunës,
- me rrugë postare, në adresë Kuvendi i Komunës së Tuzit – Shërbimi i kuvendit
Tuz, rruga Tuz 1, nr.44
- në e-mailin skupstina.kuvendi@tuzi.org.me

3. Mënyra e realizimit të të drejtave në qasjen e informacioneve

Qasja e informacionit mund të realizohet:

- hyrje të drejtpërdrejtë në origjinalin ose kopjen e informacionit në ambientet e Shërbimit,
- kopjimi ose skanimi i informacionit nga aplikanti tek ambientet e Shërbimit,
- sigurimin e një kopje të informacionit aplikantit nga Shërbimi direkt, me postë ose në mënyrë elektronike.

4. Zgjidhja sipas kërkesës dhe mbrojtja juridike

Me kërkesë për qasje në informacion, ai do të zgjidhet brenda 15 ditëve nga ditës paraqitja e kërkesës së rregullt, përveç në rastin e mbrojtjes së jetës dhe lirisë së personit ku në bazë të kërkesës zgjidhet brenda 48 orëve nga data e aplikimit.

Afati 15 ditësh mund të zgjalet me tetë ditë në rastet e parashikuara me Ligjin mbi qasjen e lirë në informacion.

Kundër aktit të Shërbimit që është zgjidhur mbi kërkesën për qasje të informacionit dorëzuesi i kërkesës dhe personi tjetër i interesuar mund të deklarojë ankesë te Agjencioni për mbrojtjen e të dhënave personale dhe qasje të lirë të informacionit.

Qasja në informacion realizohet brenda tre ditëve nga data e dorëzimit të vendimit për aplikantin përkatësisht brenda pesë ditëve nga data në të cilën parashtruesi i kërkesës dorëzoi provën e pagesës së kostove të procedurave.

5. Shpenzimet e procedurës

Shpenzimet e procedurës i kryen parashtruesi i kërkesës.

Shpenzimet e procedurës kanë të bëjnë me vetëm shpenzimet reale në pikëpamje të kopjimit, fotokopjimit, skanimit dhe dorëzimit të informacionit të kërkuar, në pajtim me rregulloren e Qeverisë së Malit të Zi.

Nëse parashtruesi i kërkesës është person me invaliditet dhe person me gjendje të nevojës sociale, shpenzimet e procedurës i kalojnë Shërbimit.

Shpenzimet e procedurës paguhen para përfundimit të aktvendimit.

Shpenzimet e procedurës paguhen në të mirë të Buxhetit të Komunës së Tuzit në xhironlogarinë 530-33762334-23 me shënimin -- qasje ndaj informacioneve.

IV – PËRSONAT E AUTORIZUAR DHE PËRGJEGJËS

Personi për udhëheqjen e procedurës dhe sjelljen e aktvendimit, sipas kërkesës për qasje të informative është Nermin Aibashiq Jurist i diplomuar.

V – Publikimi i Manualit

Ky manual është i publikuar në web faqen e Komunës së Tuzit.

Numër: 02-037/23- 672

Tuz, 26.01.2023. god.

